

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "Alpha -SK" " SH.P.K.

Sot, me datë 11.01.2022

Znj. Klotilda Lutaj shtetase Shqiptar, lindur më 06/08/1975, në *Orikum, Shqiperi*, mbajtës I Kartes se ID me nr 034245912 , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Znj. Suela Zyberaj shtetase Shqiptar, lindur më 20/10/1974, në Tirane, Shqiperi, mbajtës I Kartes se ID me nr 033823037 , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligji nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Alpha-SK**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Alpha-SK**" "Sh.p.k. Emri Tregtar I Shoqerise:"Primo Hotel"

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: TIRANE Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Medar Shtylla, Ndertesa Nr.35.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvèç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimitarisë së saj:

- *Aktivitetet ne fushen e hotelerise, sherbimeve te akomodimit, bar, restorant, Sherbim take away delivery, catering. Import - export te artikujve te ndryshem ushqimor dhe industria I, etj.*

Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, qe do te vleresohen te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kane objekt te ngjashem apo te perafert me te vetin. Gjithashtu, brenda kufijve te percaktuar nga ligji mund te leshoje garanci, letra demshperblimi dhe fdo garanci tjeter real, etj.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimitarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 Lek dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

Znj. Klotilda Lutaj zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lek dhe 50.000 Lek të kapitalit themeltar.

Znj. Suela Zyberaj zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 Lek dhe 50.000 Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, *Z. Stiven Lutaj* e cila zjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar Z. _____, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. _____, për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Znj. Klotilda Lutaj

Klotilda Lutaj


Znj. Suela Zyberaj

Suela Zyberaj
